

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës
trajtimin ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/319
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. K4/ I72-2 Prot.
Nr. 202503480/2Dok.

Tiranë 17/12/2025

Lënda: *Rekomandim në lidhje me monitorimin e Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale (I.E.V.P.)- në Tepelenë.*

Drejtuar: **Z. Klevis QOSE**
Drejtore i Përgjithshëm i Burgjeve

TIRANË

I nderuar,

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin e deritanishëm dhe duke vlerësuar angazhimin dhe punën e të gjithë stafit të institucionit që ju drejtoni, si dhe frymën e mirë të bashkëpunimit dhe mirëkuptimit midis institucioneve tona, në vijim po ju njohim mbi gjetjet dhe rekomandimet nga monitorimin që institucioni i Avokatit të Popullit kreu në I.E.V.P. Tepelenë më datë 18.09.2025.

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës, Trajtimin ose Dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues në vijim Mekanizmi Kombëtar ose MKPT, seksion pranë Avokatit të Popullit, bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar dhe nenin 81 të ligjit nr. 81/2020 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", kreu një inspektim në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale, sipas një Planit Inspektimi të miratuar nga Avokati i Popullit. Në përbërje të grupit inspektues ishin znj. Nertila Qafzezi, znj. Lindita Dedegjoni dhe znj. Gloria Çarkaxhiu me detyrë nd/komisionere pranë këtij Mekanizmi.

Qëllimi i vizitës inspektuese ishte vlerësimi i përgjithshëm i respektimit të drejtave të të burgosurve, të cilat u garantohen me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, aktet ligjore si dhe standardet ndërkombëtare për të drejtat themelore të tyre. U inspektuan ambientet në regjimin e brendshëm të institucionit, në lidhje me plotësimin e kushteve

materiale dhe infrastrukturore për jetesë dhe zhvillimin e aktiviteteve për të burgosurit, si dhe u verifikua zbatimi i rekomandimeve të Avokatit të Popullit në inspektimin e mëparshëm.

Vizita inspektuese ishte e pa lajmëruar dhe u zhvillua pa mbikëqyrjen e stafit të institucionit gjatë zhvillimit të intervistave me të paraburgosurit. Grupit të monitorimit iu krijuan kushte pune nëpërmjet një bashkëpunimi të frytshëm me drejtuesit dhe stafin e institucionit, me qëllim arritjen e objektivave të inspektimit dhe në përputhje me metodologjinë e inspektimit në burgje.

Ekspertët e MKPT-së, patën akses të plotë për të inspektuar ambientet e banimit të të burgosurve, vendet e ajrimit, dhomat e observimit dhe të veçimit, klasat e edukimit, kuzhinën, lavanderinë etj, si dhe bënë këqyrjen e dokumentacionit që administrohej nga secili prej sektorëve të institucionit. U zhvilluan gjithashtu edhe intervista konfidenciale me të paraburgosurit, në përputhje me Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve.

Sa më sipër grupi i inspektimit lidhur me ankesat e administruara përgjatë monitorimit do të trajtohen nga MKPT si dhe nga Seksioni i Veçantë pranë Institucionit të Avokatit të Popullit.

Institucioni i Avokatit të Popullit, pasi u njoh me konstatimet e grupit të inspektimit, ka detyrimin ligjor t'ju parashtrojë gjetjet e këtij inspektimi, si më poshtë vijon:

Shënime paraprake

Kjo ishte vizitë periodike monitoruese e Avokatit të Popullit në IEVP në Tepelenë për vitin 2025. Inspektimi ishte i paparalajmëruar dhe u zhvillua pa mbikëqyrjen e stafit duke zhvilluar biseda konfidenciale me të paraburgosurit.

Drejtori i institucionit z. Redi Rama, pasi u njoh me planin e inspektimit, informoi lidhur me kushtet e trajtimit dhe situatën e respektimit të të drejtave të paraburgosurve në këtë institucion. Në vijim, grupi inspektues kërkoi nga shefat e sektorëve dhe të shërbimeve vënien në dispozicion të kopjeve të dokumentacionit lidhur me organikën, programet vjetore të punës dhe aktiviteteve të sektorit juridik, sektorit të kujdesit dhe shërbimit social, të shërbimit shëndetësor, sektorit të policisë, etj.

Ky institucion ka **një kapacitet maksimal prej 75 personash** i përcaktuar me urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve me Nr. 735 Prot, datë 04.05.2023. Në ditën e inspektimit në mjediset e institucionit ishin **41** të paraburgosur.

Gjendja e popullimit në IEVP Tepelenë për 6-mujorin e fundit paraqitet si më poshtë:

Muaji mars	85 / 10 persona mbi kapacitet;
Muaji prill	82/ 7 persona mbi kapacitet;
Muaji maj	78 paraburgosur / 3 persona mbi kapacitet;
Muaji qershor	69 paraburgosur;
Muaji korrik	65 paraburgosur;
Muaji gusht	41 paraburgosur;

Nisur nga statistikat e mësipërme, rezulton se në IEVP Tepelenë nuk ka patur situata të rënda mbipopullimi dhe numri i të paraburgosurve të akomoduar në institucion ka vijuar në ulje të numrit të paraburgosurve. Avokati i Popullit shpreh vlerësimin për arritjen e këtij standardi duke u bazuar dhe në rekomandimet e Komitetin për Parandalimin e Torturës. Vizita e vitit 2023 tregoi edhe një herë se autoritetet shqiptare duhet t'i kushtojnë një prioritet të lartë masave të hartuara për të trajtuar problemin e mbipopullimit të burgjeve në rrënjët e tij, në mënyrë që t'i jepet fund këtij fenomeni njëherë e përgjithmonë.

CPT rekomandon që autoritetet shqiptare të dyfishojnë përpjekjet e tyre për të luftuar mbipopullimin e burgjeve, duke marrë parasysh rekomandimet përkatëse të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës¹. Kjo duhet të përfshijë zhvillimin e mëtejshëm të përdorimit të alternativave ndaj burgimit dhe miratimin e masave për të lehtësuar ri-integrimin e të burgosurve në shoqëri.

Organika e IEVP Tepelenë përbëhej nga 113 punonjës nga të cilët 80 ishin punonjës të policisë së burgjeve dhe 33 punonjës civilë. Përgjatë inspektimit grupi i punës konstatoi se kishte 4 mungesa në stafin civil nga të cilët 1 infermier, 1 stomatolog (aktualisht në institucion ishte i punësuar një stomatolog me kohë të pjesshme 4-orë pune në ditë) dhe 1 kuzhinier. Gjithashtu, në institucion vazhdonte të ishte në mungesë mjeku me kohë të plotë. Në sektorin e policisë në mungesë ishin 8 punonjës.

Në përgjigje të rekomandimeve të Avokatit të Popullit me shkresën nr.1400 prot. datë 17.12.2024, Drejtuesi i I.E.V.P Tepelenë na bën me dije se lidhur me zbatimin e rekomandimit mbi “Marrjen e masave për plotësimin e pozicionit të mjekut me kohë të plotë sipas parashikimeve në organikën e institucionit”, aktualisht në qarkun e Tepelenës numri i mjekëve është i vogël dhe e vetmja mundësi është punësimi i mjekut

¹ Në veçanti, Rekomandimet R(99)22 në lidhje me mbipopullimin e burgjeve dhe inflacionin e popullsisë së burgjeve, Rec(2003)22 për lirimin me kusht (lirimin me kusht), Rec(2006)13 për përdorimin e paraburgimit, kushtet në të cilat duhet të bëhen dhe sigurimi i masave mbrojtëse kundër abuzimit, Rekomandimi Rec(2010)1 për Rregullat e Provës së Këshillit të Evropës, Rec(2014)4 për monitorimin elektronik dhe Rec(2017)3 mbi Rregullat Evropiane për sanksionet dhe masat e komunitetit

me kohë të pjesshme. Sipas informacionit të dërguar deri më tani as IEVP Tepelenë as Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve nuk ka patur kërkesa për punësim me kohë të plotë të pozicionit të mjekut.

Grupi i inspektimit u informua se në bazë të Urdhrit të Ministrit të Drejtësisë nr. 6063/2 Prot, datë 16.12.2024, “Për klasifikimin e institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale”, Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP) Tepelenë është kategorizuar si institucion për të dënuarit e rritur dhe institucion paraburgimi, me një seksion siguri e zakonshme dhe një seksion paraburgimi.

Në bashkëbisedimin me drejtorin e këtij institucioni, grupi inspektues kërkoi një informacion të përgjithshëm mbi gjendjen e respektimit të të drejtave dhe trajtimin e të burgosurve nga ana e stafit dhe punonjësit e policisë së institucionit, si dhe mënyrën e trajtimit dhe adresimit të problematikave pranë organeve eprore, për zbatimin e rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit nga inspektimi i mëparshëm² nga ku rezultoi se:

1. Ishte plotësuar rekomandimi për miratimin nga Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve, së Rregullores së Brendshme të IEVP Tepelenë.
2. Ishin marrë masa për plotësimin e vendit vakant të psikologut dhe punonjësit social.
3. Ishin marrë masa lidhur me ndërveprimin e sektorit juridik me të burgosurit.
4. Ishin marrë masat për pajisjen e mjedisit të veçantë “dhomës së prindërimit në distancë” me orendi si karrige, tavolina dhe krijimin e një ambienti sa më familjar për fëmijët.
5. Ishin marrë masat për uljen e kapacitetit akomodues së këtij burgu deri në mbylljen e plotë të tij.
6. Ishin marrë masa për furnizimin me efikasitet të medikamenteve për të garantuar shëndetin e të paraburgosurve.

Ndërkohë që një pjesë e rekomandimeve të paraqitura nga Avokati i Popullit nuk kishin gjetur zbatim dhe nuk ishin plotësuar si vijon:

1. Nuk ishin marrë masa për plotësimin e pozicionit të mjekut me kohë të plotë sipas parashikimeve në organikën e institucionit.

² Rekomandim nr. K4/I77-2 dat 12.11.2024, Rekomandim në lidhje me monitorimin e Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale (I.E.V.P.)-në Tepelenë. “Rekomandohet përmirsimi i kushteve dhe i trajtimit të të paraburgosurve”.

2. Nuk ishin marrë masat për krijimin e ambienteve të përbashkëta në I.E.V.P Tepelenë.
3. Nuk ishin marrë masa për pajisjen e Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale (I.E.V.P), Tepelenë me ambulancë për të shoqëruar personat në spitalet përkatëse të vendit.
4. Nuk ishin marrë masat për krijimin e ambienteve për ushtrimin e riteve fetare.
5. Nuk ishin marrë masat për përmirësimin e cilësisë së ushqimit.
6. Nuk ishin marrë masat për afishimin në të gjitha ambientet e IEVP-së postertat me të drejtat e të paraburgosurve.
7. Nuk ishin marrë masat për realizimin e kurseve profesionale bazuar në kërkesat dhe nevojat e të paraburgosurve me qëllim edukimin vazhdues dhe përshtatjen e tyre pas vuajtjes së dënimit.
8. Nuk ishin marrë masat për shtimin e aktiviteteve dhe takimeve me të paraburgosurit me qëllim rehabilitimi, këshillimi, ri-integrimi, si edhe aktivitete edukative e social-kulturore-sportive.
9. Nuk ishin marrë masat për përmirësimin e kushteve higjieno-sanitare në ambientet e I.E.V.P. Tepelenë.

Në vizitën periodike në Shqipëri të kryer në IEVP Tepelenë³, nga Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës (CPT) nga data 4 deri më 15 maj 2023, CPT-ja ka vlerësuar se, duke pasur parasysh mangësitë e tij të mëdha strukturore, Burgu i Tepelenës është i papërshtatshëm për përdorim si institucion ndëshkëues, gjendja aktuale në këtë institucion godet seriozisht si për cilësinë e jetës së të burgosurve ashtu edhe për kushtet e punës së personelit. Prandaj Komiteti rekomandon që t'i jepet një prioritet i lartë tërheqjes nga shërbimi i këtij burgu.

Në përgjigjen e Qeverisë Shqiptare për raportin e CPT⁴, Qeveria Shqiptare referon se pjesë e Masterplanit për sistemin e burgjeve për vitin 2023-2030 është edhe mbyllja e burgut të Tepelenës. Ndërkohë deri në mbylljen e plotë të burgut do të merren masa për të përmirësuar kushtet e jetesës së të burgosurve në këtë IEVP.

³ <https://www.coe.int/en/web/cpt/-/council-of-europe-anti-torture-committee-cpt-publishes-report-on-albania.-1>

⁴ <https://www.coe.int/en/web/cpt/-/council-of-europe-anti-torture-committee-cpt-publishes-the-response-of-the-albanian-authorities-to-the-report-on-the-2023-visit>.

Ndërkohë duke konsideruar pozitiv faktin se përgjatë 6 muajve të parë të vitit 2025 nuk ka patur mbipopullim, Avokati i Popullit thekson se ky institucion në kushtet infrastrukturore që është edhe pse numri aktual i të paraburgosurve është 41 persona, nuk plotëson standardet për akomodimin e të burgosurve.

Trajtimi

Grupi i inspektimit, kishte për qëllim mbledhjen e informacionit lidhur me garantimin e të drejtave dhe trajtimin e personave që vuajnë dënimin në këtë institucion, identifikimin e rasteve të dhunës, përdorimin e forcës fizike apo ushtrimit të presionit psikologjik ndaj kësaj kategorie, mënyrën e trajtimit dhe zgjedhjes së kërkesë/ankesave të të burgosurve, procedurat që ndiqen nga komisioni për pritjen e tyre në institucion, komisionin për dhënien e masave disiplinore, aktivitetet e zhvilluara, trajtimin shëndetësor, cilësinë e ushqimit, furnizimin sipas normativës me detergjente dhe mjete të higjienës personale etj.

Nga intervistat e zhvilluara me të paraburgosurit, grupi i inspektimit nuk evidentoi raste apo pretendime për keqtrajtime dhe tejkalim të forcës fizike nga punonjësit e sigurisë të këtij institucioni. Sikurse ata pohuan në këto intervista, marrëdhëniet e stafit me të burgosurit, janë të mira dhe korrekte. Mekanizmi Kombëtar vlerëson këtë fakt dhe shpreh besimin që kjo frymë do të jetë e qëndrueshme.

Ankesat nga të paraburgosurit ishin si më poshtë:

Ankesa kishte për ushqimin në drejtim të larmishmerisë së vakteve, nga inspektimi në ambientin e kuzhinës ishte e afishuar menuja javore e vakteve ushqimore nga e cila konstatuam se vaktet ushqimore gjatë javës ishin të njëjta dhe mungonte larmishmëria e produkteve si dhe ndryshimi i tyre me zëvendësim gjatë ditëve. Në rregulloren e përgjithshme e burgjeve evropiane 2020 është përcaktuar⁵: Ushqimi duhet të përgatitet dhe shërbehet në mënyrë higjienike. Mjeku ose autoriteti tjetër kompetent do të inspektojë rregullisht, do të mbledhë informacione me mjete të tjera nëse është e përshtatshme dhe do ta këshillojë drejtorin ndër të tjera për sasinë, cilësinë, përgatitjen dhe shërbimin e ushqimit dhe ujit, higjiena dhe pastërtia e institucionit dhe të burgosurve.

Ankesa kishte për mungesën e higjienës në institucion, sipas të paraburgosurve në dhomat e banimit kishte prezencë të insekteve dhe se nuk ishte kryer dezinfektimi i burgut. Ambientet e qelive nuk pastrohen apo dezinfektohen në mënyrë të rregullt, ka prani të konsiderueshme insektesh (buburreca, pleshta, mushkonja etj.) mungon ventilimi, si dhe higjiena e dyshekëve, bataniave dhe objekteve të përdorimit personal.

⁵ <https://www.apr.ch/knowledge-hub/dfd/food-and-water>.

Këto kushte jo vetëm që përbëjnë një rrezik të drejtpërdrejtë për shëndetin fizik dhe mendor të personave të privuar nga liria, por gjithashtu bien ndesh me standardet minimale ndërkombëtare për trajtimin e të dënuarve, si dhe me të drejtat bazë të garantuara nga Kushtetuta dhe Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Shqetësim për ta ishte mungesa e ambienteve për aktivitete, të vetmet aktivitete ishin futbollit, lojëra tavoline, domino dhe orari i ajrimit.

Të paraburgosurit e konsideronin jo në nivelin e duhur, shërbimin e sektorit psiko-social në I.E.V.P Tepelenë. Shkak për këtë ishte mungesa e ambienteve të përbashkëta për kryerjen e aktiviteteve sociale dhe edukuese.

Gjithashtu, sipas të paraburgosurve, shërbimi mjekësor në këtë institucion nuk ishte i rregullt dhe nuk ofrohej në kohë dhe në cilësi. Ankesa kishte dhe për vizitat mjekësore

Ankesa kishte për mungesën e ambulancës. Sipas tyre në rast të paraqitjes së një komplikacioni shëndetësor të të paraburgosurit, makina e shoqërimit shërben si mjet për transportimin e tyre në spitalin rajonal, ose në spitalin e Gjirokastrës.

Ankesa kishte gjithashtu, për mungesën e kurseve profesionale si dhe ato të gjuhës së huaj bazuar në kërkesat dhe nevojat e të dënuarve me qëllim edukimin vazhdues dhe përshtatjen e tyre pas vuajtjes së dënimit.

Ankesa kishte për mungesën e ambienteve për ushtrimin e rriteve fetare.

Masat mbrojtëse

Nga verifikimi dhe inspektimi i dokumentacionit lidhur me sistemin e kërkesë/ankesave rezultoi se çdo gjë regjistrohej në regjistrin përkatës dhe protokollohej. Regjistrat mbaheshin nga sekretaria e institucionit. Nga verifikimi i regjistrit të kërkesë-ankesave rezultoi se nga muaji janar deri në datën 18.09.2025 ishin regjistruar 650 kërkesa ku më së shumti rezultojnë ato për shërbime mjekësore.

Të paraburgosurit plotësonin një formular kërkesë/ankese dhe ia dorëzonin më pas punonjësit të sektorit psiko-social. Punonjësi i dërgonte në sekretarinë e institucionit ku protokolloheshin dhe pastaj i kalonin drejtorit të institucionit, i cili kthente përgjigje me shkrim apo i takonte vetë të paraburgosurit.

Sistemi i monitorimit me kamera vëzhgimi ishte funksional. Në IEVP Tepelenë ishin të instaluar 28 kamera të cilat monitoronin pjesën më të madhe të mjediseve për 24 orë, dhe ruajtja e pamjeve filmike në server kryhej për 30 ditë.

Observimi si sektor i rëndësishëm për mbajtjen dhe kujdesin e veçantë të të paraburgosurve të cilët akomodohen rishtazi në I.E.V.P. Tepelenë funksiononte dhe ishte i pajisur me orendi.

Komunikimi me telefon me familjarët kryhej 8 herë në muaj nëpërmjet telefonave me kartë, të cilët ishin të instaluar në mjedisin e regjimit të brendshëm. Nga verifikimi i aparateve telefonike me kartë u konstatua se, të paraburgosurit mund të lidheshin pa pagesë me numrin e telefonit të Avokatit të Popullit⁶.

Takimet me familjarë zhvilloheshin 4 herë në muaj si dhe një herë në muaj nëpërmjet platformës online kjo në zbatim të pikës 10 të nenit 70 të Vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) me nr. 209, dt. 6.04.2022 “ Për miratimin e rregullores së përgjithshme të burgjeve” parashikohet se: Të burgosurit kanë të drejtë të zëvendësojnë 1 (një) vizitë fizike me atë online dhe të kryejë të paktën 4 herë në muaj takime.

Në I.E.V.P. Tepelenë ishte krijuar dhoma për të paraburgosur që kishin fëmijë të vegjël lidhur me ushtrimin e të drejtës së prindërimit në distancë, me të cilët mund të takoheshin pa barriera apo kufizime fizike, ky ambient ishte e pajisur me orendi dhe ishte miqësor me fëmijët.

Aktualisht të punësuar në institucion ishin 4 të paraburgosur në pozicionet si sanitar, shpërndarës ushqimi dhe 2 berber.

Nga takimi i grupit inspektues më të paraburgosurit që punonin brenda institucionit këta të fundit nuk kishin pretendime për kushtet e punës. Ndaj tyre ishin lidhur kontratat e punësimit midis të paraburgosurve të punësuar dhe institucionit, në zbatim të VKM-së nr. 602, datë 13.10.2021, për shpërblimin financiar për punën e kryer.

Nga inspektimi i të gjitha ambienteve në IEVP konstatuam se po ashtu si edhe nga inspektimi i një viti më parë mungonin posterat me të drejtat e të paraburgosurve në vende të aksesueshme.

Kushtet materiale

Grupi i monitorimit, në fokus të vizitës së tij pati edhe monitorimin e kushteve materiale, të rëndësishme për respektimin e standardeve normale të jetesës. I.E.V.P.

⁶ VKM me nr. 209, dt. 6.04.2022 “Për miratimin e rregullores së përgjithshme të burgjeve” në të cilën është përcaktuar qartë në nenin 65 se: I burgosuri mund të komunikojë në telefon me Avokatin e Popullit pa pagesë dhe në çdo kohë, bazuar në procedurat që përshkruhen në ligjin për të drejtat dhe trajtimin e personave të dënuar me burgim dhe të paraburgosurve. Numrat e telefonit të Avokatit të Popullit nuk përfshihen në listën e numrave të telefonit, të miratuar për çdo të burgosur.

Tepelenë është një institucion i vjetër i trashëguar nga sistemi komunist. Infrastruktura e godinës ofron dy kate akomodimi dhe përbëhet nga një godinë me 26 dhoma banimi dhe ambiente ajrimi të jashtëm. Në çdo kat kishte nga 12 dhoma.

Në institucion ndodheshin 2 të paraburgosur të moshës 18-21 vjeç. Nga takimi me të paraburgosurit ata nuk referuan raste dhune. Ata ishin vendosur në një dhomë e cila kishte hapësirë dhe plotësonte standardet e jetesës, dhe shërbente për akomodimin e 4 personave gjithashtu kishin dhe ambientin e ajrimit të veçantë për këtë grupmoshë.

Paraqitja e godinës së banimit përbëhet nga 26 dhoma si më poshtë:

Kati i parë me 11 dhoma banimi me sipërfaqe të njëjtë 5.4 m x 2.5 m plus dy dhoma të cilat shërbenin, njëra si dhomë veçimi me përmasa 5.4 m x 2.5 m dhe dhoma tjetër e cila funksionon si tualet dhe dushe të përbashkëta me sipërfaqe 4 m x 2.5m.

Kati i dytë me 12 dhoma banimi me përmasa 5.5 mx 2.4 m. Të dyja katet kanë nga një korridor 27.5 metra të gjatë dhe 1.5 metra të gjerë.

Në institucion ka një dhomë veçimi dhe një dhomë observimi, të cilat kanë dritë natyrale dhe dritë artificiale gjithashtu janë të pajisura me 2 shtretër me sfungjer.

Lidhur me kushtet në regjimin e burgut u vërejtën:

Dhomat të gjitha kanë ndriçim natyral dhe artificial dhe janë të pajisura me tualete. Pothuajse të gjitha dhomat kishin tualete brenda. Ajrimi për katet kryhej në ambiente të veçanta të ndara nga njëra-tjetra.

Në I.E.V.P.Tepelenë përveç ambienteve të ajrimit dhe një dhomë e cila përdoret si bibliotekë nuk ka ambiente të tjera të përbashkëta.

Ambientet e takimit me familjarët gjendeshin në një dhomë të përbashkët për të dy sektorët. Në këtë ambient të takimeve gjendeshin 3 sportele të ndara me kangjella hekuri.

Probleme kishte me higjienën e mjediseve nisur nga fakti që institucioni në tërësinë e tij ishte i amortizuar. Në ditën e inspektimit konstatuam se ambientet ishin të palyera dhe të padizinfektuara. Përgjatë kalimit në korridor dhe ambientet e dhomave të të paraburgosurve vërehej një ajër i rënduar dhe prania e insekteve.

Nga intervistat e bëra nëpër dhoma me të paraburgosurit pati shumë ankesa për mungesën e investimeve në I.E.V.P. Tepelenë për të garantuar cilësinë e higjienës brenda në institucion.

Gjatë inspektimit u evedentua se, dhomat e banimit ishin të kompletuara me materiale për fjetje dhe me orënditë e nevojshme si tavolina, karrige dhe komodina për një jetesë normale. Në intervistat me të paraburgosurit, nuk u paraqitën ankesa në lidhje me furnizimin me materiale fjetje dhe orënditë e nevojshme për mbajtjen e sendeve personale dhe të ushqimeve. Të paraburgosurit deklarorin se këto materiale i kishin siguruar nga familjarët e tyre, në mungesë të dollapëve, të paraburgosurit i mbanin sendet e tyre personale në komodina. Ngrohja e ambienteve në regjimin e brendshëm, në mungesë të një sistemi qendror ngrohje/ftohje, realizohej me pajisje elektrike të siguruara nga të paraburgosurit.

Në I.E.V.P. Tepelenë larja në dushe zhvillohej mesatarisht dy herë në javë. Dushet ishin të instaluara nga 2 në çdo regjim përkatësisht 2 në katin e parë të godinës dhe 2 në katin e dytë. Cilësia e ujit ishte e mirë dhe furnizimi në një pjesë të institucionit ishte 24 orë në ditë.

Lavanderia ndodhej në ambientin e jashtëm të regjimit. Ajo ishte e pajisur me një lavatriçe e cila përdorej për larjen e batanijeve ndërsa teshat për larje të paraburgosurit i dërgonin në familje. Përgjatë inspektimit u informuam se institucioni ishte pajisur me një lavatriçe profesionale për larjen e teshave dhe pritej që të vihej në funksion.

Kuzhina funksiononte në kushte normale e pajisur me pajisjet e gatimit dhe sistemi i aspirimit ishte funksional. Në IEVP Tepelenë punonin 3 kuzhinierë pasi 1 kuzhinier ishte në mungesë. Në kuzhinë ndodhej regjistri i normativave ushqimore dhe menyja ditore ishte e afishuar. Regjistrat e kontrollit të ushqimit dhe të menisë së gatimit ishin të sekretuar dhe të protokolluar. Ushqimi ofrohet rregullisht tre vakte.

Përgjatë inspektimit konstatuam se kampionët e ushqimeve mbaheshin në kushte frigoriferike si dhe të etiketuara sipas vakteve përkatëse.

Kushtet e përgatitjes së ushqimit në ambientet e kuzhinës të institucionit, rezultuan në gjendje të mirë. Nga inspektimi u konstatua se sasia dhe cilësia e gatimit ishte sipas urdhrit të përbashkët të Ministrisë të Drejtësisë dhe Ministrisë të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale⁷.

Përgjatë inspektimit u evedentua se një masë e madhe e të burgosurve në IEVP Tepelenë nuk e konsumojnë ushqimin e përgatitur në institucion, duke shpërdoruar një pjesë të konsiderueshme të tij. Ata pohuan se e merrnin ushqimin nga të afërmit e tyre

⁷ Urdhër i përbashkët i Ministrisë të Drejtësisë nr.1126 prot, datë 22.02.2022 dhe Ministrisë të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr.995/1 prot., datë 07.03.2022 “Për miratimin e normave të ushqimit ditor për të dënuarit”.

dhe se nuk e konsumonin ushqimin e institucionit për shkak se nuk e pëlqenin atë dhe se menuja ushqimore ishte e njëjtë për çdo vakt ushqimor.

Në I.E.V.P. Tepelenë funksiononte sistemi i blerjes on-line i produkteve ushqimore nga të paraburgosurit.

Referuar dokumentacionit evidentohet se furnizimi me produktet bazë të higjienës për të pastruar dhomat ishte kryer rregullisht sipas furnizimit mujor për të paraburgosurit.

Regjimi dhe aktivitetet

Gjatë inspektimit u vu re se nuk zhvilloheshin aktivitete të përbashkëta. Në lidhje me ajrimin u konstatua se ajrimi ditor zgjaste mbi 3 (tre) orë sipas rregullores. Shumë prej të intervistuarve nëpër dhoma të pyetur për aktivitetet apo programet që ata marrin pjesë kërkuan të kenë aktivitete të përbashkëta edukative ose sportive dhe më shumë mjete dhe pajisje sportive.

Trajnime profesionale: Në I.E.V.P. Tepelenë nuk zhvilloheshin trajnime profesionale pasi në këtë njësi administrative nuk kishte shërbime të tilla të ofruara nga Qendra Rajonale e Formimit Profesional apo organizata të ndryshme.

Avokati i Popullit thekson se kurset profesionale shërbejnë si një mjet thelbësor për rehabilitim, duke i pajisur të burgosurit me mjete efektive për tu aftësuar dhe për t'u integruar më lehtë në shoqëri pas lirimit. Qëllimet kryesore të zhvillimit të kurseve profesionale në ambientet ku privohet liria e personit janë të një rëndësie të veçantë të cilat lidhen drejtpërdrejt me:

- Rehabilitimin: Ndhmon të burgosurit të ndryshojnë sjelljen e tyre dhe të zhvillojnë një perspektivë pozitive për të ardhmen.
- Integrimi: Të përgatisin të burgosurit për t'u riintegruar në tregun e punës dhe në shoqëri pas lirimit.
- Rritja e vetëbesimit: Të rrisin vetëbesimin e të dënuarve dhe të i bëjnë ata të ndjehen më të aftë për të kontribuar në shoqëri.
- Parandalimi i recidivizmit: Të reduktojnë probabilitetin që një person të kryejë një krim të ri pas lirimit.
- Uljen e nivelit të agresivitetit: Duke i dhënë të dënuarve një qëllim dhe një mënyrë për të shpenzuar kohën e tyre në mënyrë produktive.
- Përmirësimin e shëndetit mendor duke u ofruar të dënuarve një ndjenjë të arritjes dhe të vetëvlerësimit.

Kjo problematikë është evidentuar edhe në Raportin drejtuar Qeverisë Shqiptare mbi vizitën e CPT në Shqipëri të kryer në datat 4-15 maj 2023, CPT u bën thirrje autoriteteve shqiptare të marrin masat e nevojshme në Burgun e Tepelenës (dhe në burgjet e tjera në Shqipëri ku mbizotëron një situatë e ngjashme) për të përmirësuar ndjeshëm regjimin e veprimtarive për të gjithë të burgosurit, pavarësisht nga statusi i tyre ligjor. Qëllimi duhet të jetë të sigurohet që të burgosurit të jenë në gjendje të kalojnë një pjesë të arsyeshme të ditës (d.m.th., tetë orë ose më shumë) jashtë qelisë së tyre të përfshirë në aktivitete të qëllimshme të natyrave të ndryshme **si punë, arsim, trajnim profesional, sport, dhe aktivitete rekreative/shoqërimi.**

Institucioni kishte një klasë për edukimin dhe përdorej edhe si bibliotekë e pajisur me disa titujsh librash. Ato viheshin në dispozicion të paraburgosurve për lexim sipas kërkesave. Të paraburgosurit e regjistruar kishin nga një kartelë personale dhe nëpërmjet saj tërhiqnin dhe dorëzonin librat sipas kërkesave.

Është për t'u theksuar se një ndër qëllimet e institucioneve të mbyllura penitenciare është riintegrimi në shoqëri i personave, në momentin kur do të lënë burgun. Rregullorja Evropiane e Burgjeve parashikon se *“regjimi i ofruar për të gjithë të burgosurit përfshin një program të balancuar veprimtarish. Ky regjim u lejon të gjithë të burgosurve të kalojnë sa më shumë orë në ditë jashtë qelive të tyre, sipas nevojës për një nivel të përshatshëm të ndërveprimit njerëzor dhe shoqëror”*⁸.

Nga shqyrtimi i dosjeve psiko-sociale dhe dokumentacioneve të tjera të mbajtura nga ky sektor, u vu re se ato ishin të plotësuara me shënime periodike mbi takimet dhe aktivitetet ku të paraburgosurit merrnin pjesë si dhe vlerësimet periodike.

Shërbimi Shëndetësor

Gjatë vizitës në IEVP Tepelenë si dhe nga intervistat me të paraburgosurit, problematikat u konstatuan lidhur me shërbimin shëndetësor.

Personeli i kujdesit mjekësor në IEVP, Tepelenë përbëhej nga 1 (një) mjek i cili ishte i punësuar me kohë të pjesshme, 1 (një) farmacist, 1 (një) stomatolog i punësuar me kohë të pjesshme dhe 5 (pesë) infermierë, ku 1 (një) ndër të cilët ishte në mungesë.

Mjeku aktual punonte me kohë të pjesshme 4 orë në ditë. Dhoma e mjekut, farmacistit, apo infermierisë ishin lyer rishtas megjithëse si të gjithë ambientet e këtij institucioni, kishin nevojë për investime tërësore. Dhoma e infermierisë ishte e vogël me kushte të mira higjieno-sanitare dhe aty mbaheshin edhe një sasi e vogël ilaçesh për urgjencën.

⁸ Rregullorja e Evropiane e Burgjeve Pika 25.1 dhe 25.2; <http://www.coe.int/t/DGHL/STANDARD`SETTING/PRISONS/EPR/EPR-Albanian.pdf>

Në këtë institucion u vu re se mungonte ambulanca për të shoqëruar personat në spitalet përkatëse të vendit.⁹

Në I.E.V.P. Tepelenë u evidentua se ndodhen 4 të paraburgosur me probleme të shëndetit mendor dhe 8 të paraburgosur kronikë. Avokati i Popullit vlerëson se në I.E.V.P. Tepelenë duhet të krijohet një Sektor i Kujdesit të Veçantë për të paraburgosurit me probleme të shëndetit mendor. Për këtë kategori duhet të tregohet kujdes i veçantë sa i takon përzgjedhjes së standardeve të dhomave ku do të qëndrojnë, ndaj higjienës vetjake të tyre, si dhe të mjedisit që i rrethon.

Nga këqyrja e dokumentacionit të stafit mjekësor, e në veçanti atij të mjekut, u konstatua se kartelat klinike mbaheshin në dollap të mbyllura me çelës në dhomën e mjekut. Gjithashtu, u këqyrën regjistri i vizitave të mjekut, regjistrat e informacionit 24 orësh të infermierëve, të cilat rezultuan se ishin mbajtur me rregull.

Të paraburgosurit ishin të pajisur me libreza shëndetësore. Skema e furnizimit dhe rimbursimit të ilaçeve në I.E.V.P Tepelenë sipas kontratës tre paleshe ISKSH, depo farmaceutike funksiononte rregullisht për 11 të paraburgosur.

Për sa më sipër dhe në mbështetje të pikës 3, të nenit, 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”*; të nenit 21, germa “b” të ligjit nr. 8454 dt. 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, i ndryshuar, ku thuhet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive; si dhe në bazë të Nenit 74/1 pika “b” të Ligjit Nr. 8328 dt. 16.04.1998, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, i ndryshuar ku parashikohet midis të tjerash se: “Avokati i Popullit nëpërmjet Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës ka këto kompetenca: b)të paraqesë rekomandime për organet përkatëse, me qëllim që të përmirësohet trajtimi dhe kushtet e individëve që u është hequr liria dhe të parandalohet tortura dhe trajtimi ose dënimi i egër, çnjerëzor dhe poshtërues”*.

⁹ Rregullorja Evropiane e Burgjeve, pika 39, 40.1, 40.5; *“Autoritetet e burgut ruajnë shëndetin e të gjithë të burgosurve që janë në kujdesin e tyre. Shërbimet mjekësore në burg organizohen në bashkëpunim të ngushtë me administrimin shëndetësor të komunitetit ose të shtetit. Të burgosurit i ofrohen shërbimet mjekësore, kirurgjike dhe psikiatrike, duke përfshirë dhe ato shërbime që janë të disponueshme në komunitet”*.

REKOMANDOJMË:

Marrjen e masave për mbylljen e Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale Tepelenë. Deri në mbylljen e tij të merren masat e mëposhtme:

1. Marrjen e masave të menjëhershme për kryerjen e dizinfektimit dhe higjienizimit të të gjithë ambienteve të I.E.V.P. Tepelenë.
2. Marrjen e masave për plotësimin e pozicionit të mjekut me kohë të plotë sipas parashikimeve në organikën e institucionit si dhe pozicionet vakante në institucion.
3. Marrjen e masave të menjëhershme për riparime, mirëmbajtje dhe eliminimin e lagështirës për krijimin e kushteve sa më dinjitoze brenda dhomave të banimit.
4. Marrjen e masave të menjëhershme për krijimin e ambienteve të përbashkëta në I.E.V.P Tepelenë.
5. Marrjen e masave të menjëhershme për pajisjen e Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale (I.E.V.P), Tepelenë me ambulancë për të shoqëruar personat në spitalet përkatëse të vendit.
6. Marrjen e masave për krijimin e ambienteve për ushtrimin e riteve fetare.
7. Marrjen e masave për sigurimin e sistemit ngrohje/ftohje në ambientet e banimit të I.E.V.P Tepelenë.
8. Marrjen e masave për pajisjen e dhomave të të paraburgosurve me dyshekë, batanije dhe objekteve të përdorimit personal të cilat janë jashtë standardeve për një jetesë dinjitoze.
9. Marrjen e masave për afishimin në të gjitha ambientet e IEVP-së të posterave me të drejtat e të paraburgosurve.
10. Marrjen e masave për realizimin e kurseve profesionale bazuar në kërkesat dhe nevojat e të paraburgosurve me qëllim edukimin vazhdues dhe përshtatjen e tyre pas vuajtjes së dënimit.

Për qëndrimin dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor sipas nenit 22 të Ligjit Nr. 8454 dt. 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj.

**KOMISIONERI
i Mekanizmit Kombëtar
për Parandalimin e Torturës
(MKPT)**

Ahmet PRENÇI

d.v